



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kontrolli i Lartë i Shtetit

Nr. 563 Prot.



Qëndresa Qytetare

Nr. 34 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

për

“FORCIMIN E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES PUBLIKE”

- NISUR NGA:** Interesi publik për një luftë pa kompromis, transparente, të thellë dhe në sistem kundër korrupsionit, nga ndjeshmëria dhe pritshmëritë e qytetarëve për bashkëpunimin konkret dhe efikas të strukturave shtetërore me shoqërinë civile të angazhuar për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin;
- ME SYNIM:** Rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe organizatave, individëve dhe grupeve të organizuara të shoqërisë civile që synojnë me vepra dhe zotime konkrete luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës;
- DUKE RIAFIRMUAR** Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës, Ligjit integral të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të vullnetit dhe seriozitetit të organizatave të shoqërisë civile palë në këtë Marrëveshje, si dhe besimin se një bashkëpunim i sinqertë struktura publike-shoqëri civile jep rezultate konkrete në kufizimin dhe parandalimin e korrupsionit;
- NË MBËSHTETJE TË:** *Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, që përcakton Kontrollin e Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, dhe që ka si objektiv kryesor kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, miradministrimin financiar dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut për rezultatet e punës së tij;*

*Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse",
që rregullon aktivitetin e organizatave të shoqërisë civile;
Statutit të organizatës Qëndresa Qytetare miratuar me themelimin
e saj, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në 15.09.2016;*

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), i cili është autoritet kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfaqësuar nga **Kryetari z. Bujar Leskaj**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

dhe

Qëndresa Qytetare, i cili është autoritet kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfaqësuar nga **Drejtori Ekzekutiv z. Rigels Xhemollari**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

bien dakord mbi Marrëveshjen e Bashkëpunimit si më poshtë:

NENI 1 OBJEKTIVI

- 1.1 Kjo Marrëveshje do të lehtësojë vendosjen e marrëdhënieve ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- 1.2 Bashkëpunimi zbatohet duke respektuar parimin e reciprocitetit.

NENI 2 KONTRIBUTI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTESTIT

- 2.1 Kontrolli i Lartë i Shtetit, për realizimin e parimit të transparencës në ushtrimin e aktivitetit, për përmbushjen e funksionit publik për të cilin është krijuar si organ Kushtetues, në rastin e konstatimit të korrupsionit apo mashtrimit financiar gjatë auditimeve të tij dhe për masat e propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në dënimin e personave që kryejnë korrupsion në administratën e Shtetit dhe në shpërblimin e dëmit shkaktuar arkës së Shtetit, merr përsipër të njoftojë në një kohë sa më të shpejtë organizatën Qëndresa Qytetare.
- 2.2 Kontrolli i Lartë i Shtetit do të shohë të gjitha hapësirat ligjore për të mundësuar kontributin e ekspertëve të organizatës Qëndresa Qytetare në ekipet e tij të auditimit të atyre enteve shtetërore ku mungesa e transparencës dhe rreziku i lartë i korrupsionit përbën shqetësim të përbashkët të palëve.
- 2.3 Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër ta ftojë organizatën Qëndresa Qytetare në të gjitha analizat e tij të punës dhe në aktivitete publike me strukturat e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin, si dhe të organizojë aktivitete të përbashkëta (tryeza pune, seminare,

konferenca, etj.) me organizatën e lartpërmendur për sensibilizimin e opinionit publik në thellimin e luftës dhe në parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës së institucioneve shtetërore.

NENI 3

KONTRIBUTI I ORGANIZATES QENDRESA QYTETARE

- 3.1 Qëndresa Qytetare** merr përsipër të informojnë në kohë reale Kontrollin e Lartë të Shtetit për rastet e korrupsionit dhe të mungesës së transparencës në administratën shtetërore, veçanërisht në institucionet e arsimit të lartë publik, që kjo organizatë konstaton ose për të cilat vihet në dijeni, si dhe të përcjellë në vëmendje të komunitetit të shoqërisë civile dhe të opinionit publik të vendit rastet e korrupsionit apo mashtrimit financiar të zbuluara dhe të dënuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
- 3.2 Qëndresa Qytetare** merr përsipër të angazhojë ekspertë të saj, në rastet kur i krijohet kjo mundësi, në aktivitete të përbashkëta me Kontrollin e Lartë për konstatimin dhe dënimin e rasteve të korrupsionit.
- 3.3 Qëndresa Qytetare** merr përsipër të ndjekë dhe marrë pjesë në aktivitetet publike të Kontrollit të Lartë të Shtetit për thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës.

NENI 4

KONTRIBUTE TË PËRBASHKËTA

- 4.2 Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Qëndresa Qytetare** marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si për t'i ofruar njeri-tjetrit informacion reciprok, ashtu edhe për të rritur ndërgjegjësimin e administratës shtetërore dhe të opinionit publik në luftën dhe parandalimin e korrupsionit si dhe rritjen e transparencës.

NENI 5

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

- 5.1** Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.
- 5.2** Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas Nenit 1 të kësaj marrëveshje.
- 5.3** Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

NENI 6
ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT

- 6.1 Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në Ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe Ligjin Nr. 8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".


NENI 7
DISPOZITAT E FUNDIT

- 7.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 7.2 Amendamentet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 7.3 Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, palën tjetër.
- 7.4 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një prej të cilave depozitohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe një pranë organizatës Qëndresa Qytetare.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 08/05/2018.

PËR
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT

KRYETARI
BUJAR LESKAJ



PËR
QËNDRESA QYTETARE

DREJTORI EKZEKUTIV
RIGEL XHEMOLLARI

